



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR TË DREJTEN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN E TË
DHËNAVE PERSONALE

Nr. 56/7 Prot

Tiranë, më 26/2 /2015

REKOMANDIM

Nr. 09 datë 26/2 2015

Në mbështetje të neneve 29, 30 dhe 32 të ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale", i ndryshuar në ngarkim të kontrolluesit, **Televizioni Top-Channel**.

KONSTATOVA:

Pranë Zyrës së Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, në datë 26.01.2015 është paraqitur ankesa e shtetasit, subjekt i të dhënave personale z. . Ky shtetas i është drejtuar zyrës së Komisionerit me ankesë ku pretendon se, dëshmia dhe identiteti i tij u publikuan në edicionin qëndror të lajmeve të televizionit Top Channel, në cilësinë e dëshmitarit okular të ngjarjes së ndodhur, më datë në Tiranë, në . Shtetasi kërkon gjithashtu, të hiqet videoja e publikuar në faqen e internetit të televizionit Top-Channel, me link: <https://www.youtube.com/watch?v=> ku zbulohet identiteti i tij.

Zyra e Komisionerit me qëllim zgjidhjen e drejtë dhe të plotë të çështjes i është drejtuar kontrolluesit, televizioni Top-Channel me shkresën Nr. 56/3 Prot, datë 29.01.2015, nëpërmjet së cilës u kërkua informacion lidhur me veprimet e ndërmarra nga kontrolluesi, të cilat çuan në bërjen publike të identitetit të dëshmitarit, në cilësinë e ankuesit pranë Zyrës së Komisionerit. Kontrolluesi ka kthyer përgjigje me shkresën Nr. 106/1 Prot, datë 16.02.2015, me të cilën ka paraqitur sqarimet përkatëse në lidhje me rastin.

Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, vlerëson bashkëpunimin e kontrolluesit në kuadrin e dhënies së informacionit në lidhje me rrethanat e rastit konkret dhe pasi shqyrtoi parashtrimet e paraqitura nëpërmjet shkresës së sipërcituar dhe pas verifikimeve të mëtejshme vlerëson se, në rastin konkret nuk është bërë balancimi i duhur midis bërjes publike të lajmit në kuadër të interesit publik dhe të drejtës për mbrojtjen e të dhënave personale dhe privatësinë e subjektit të te dhënave.

Në referencë të neneve 2 dhe 8 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, detyrimi për t'u paraqitur si dëshmitar, është veprim që duhet të balancohet me të drejtën e jetës private të dëshmitarit dhe të familjes.

Ushtrimi i së drejtës së lirisë së shprehjes nuk është i pakufizuar sepse kërkohet të bëhet brenda kontureve të kërkesave të parashikuara në nenet 15, 17, 36, 41 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë pasi të drejtat themelore të njeriut janë të padhunueshme dhe qëndrojnë në themel të të gjithë rendit juridik dhe ato mund të kufizohen vetëm me ligj.

E drejta që rregullon fushën e privatësisë lidhur me këtë çështje është ligji nr. 9887, datë 10.03.2008, “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, i ndryshuar si dhe Udhëzimi nr. 9, datë 15.09.2009, “Për rregullat themelore në lidhje me mbrojtjen e të dhënave personale në median e shkruar, vizive dhe audiovizive”.

Në këndvështrim dhe respektim të këtij kuadri ligjor kushdo që përpunon të dhëna personale, do të ndeshet në radhë të parë me të drejtën e subjektit të këtyre të dhënave personale. Ruajtja e konfidencialitetit si një e drejtë themelore e individit për mbrojtjen e të dhënave të tij, nuk duhet të dalë si një pengesë ndaj të drejtës së lirisë së shprehjes së medias, por kjo nuk ka të bëjë me mospasjen e të drejtës së individit për të mbrojtur të dhënat e tij personale.

Media dhe të gjithë kontrolluesit duhet të respektojnë nenin 2, parimin e përgjithshëm “Përpunimi i ligjshëm i të dhënave personale bëhet duke respektuar dhe garantuar të drejtat dhe liritë themelore të njeriut dhe, në veçanti, të drejtën e ruajtjes së jetës private.” të ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008, “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”, i ndryshuar.

Në nenin 5 të ligjit parashikohet, Mbrojtja e të dhënave personale bazohet: a) në përpunimin në mënyrë të drejtë dhe të ligjshme; b) në grumbullimin për qëllime specifike, të përcaktuara qartë, e legjitime dhe në përpunimin në përputhje me këto qëllime; c) në mjaftueshmërinë e të dhënave, të cilat duhet të lidhen me qëllimin e përpunimit dhe të mos e tejkalojnë këtë qëllim;...

Në respektim të nenit 6, të ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008, “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”, i ndryshuar, për sa i përket kriterëve ligjore për përpunimin e të dhënave personale duhet verifikuar nëse ato janë përmbushur, siç parashikohet në gërmat a) nëse subjekti i të dhënave personale ka dhënë pëlqimin, ç) për përmbushjen e një detyrimi ligjor të kontrolluesit, d) për kryerjen e një detyre ligjore me interes publik ose ushtrimin e një kompetence të kontrolluesit ose të një pale të tretë, së cilës i janë përhapur të dhënat dhe në pikën dh) nëse është thelbësore për mbrojtjen e të drejtave dhe interesave legjitime të kontrolluesit, marrësit apo personave të tjerë të interesuar.

Parimet e mësipërme kanë të bëjnë me atë, që kontrolluesit nuk duhet të mbledhin dhe përpunojnë të dhëna personale kur përpunimi i tyre nuk lejohet me ligj, si dhe për qëllime të tjera nga ato për të cilat i kanë mbledhur. Në rastin konkret, Televizioni Top-Channel në këndvështrim të këtyre parimeve lidhur me publikimin e të dhënave identifikuese që kanë të bëjnë me dëshmitarin rezulton të jetë në tejkalim të qëllimit të përpunimit dhe bërjes publike të lajmit në kuadër të interesit publik. Interesi publik në rastin konkret, në momentin e publikimit, ka të bëjë me identitetin e personave të akuzuar dhe nën hetim dhe jo me dëshmitarin. Në bërjen publike të lajmit nuk është realizuar një seleksionim i informacionit me qëllim që të respektohet privatësia e personave të përfshirë në ngjarje, publikimi i të dhënave identifikuese të të cilëve nuk ka lidhje me thelbin e lajmit dhe nxjerrë informacione të cilat nuk ndikojnë në thelbin e asaj që duhet të arrihet nga publikimi i tij.

Gjithashtu, në këndvështrim të mbrojtjes së të dhënave personale dhe kuadrit nënligjor rregullues, Udhëzimit nr. 9, datë 15.09.2009 të Komisionerit “Për rregullat themelore në lidhje me mbrojtjen e të dhënave personale në median e shkruar, vizive dhe audiovizive”, kreu III, pika 6 “Mbrojtja në procedimet penale”, parashikon se “Nuk duhet zbuluar identiteti i dëshmitarëve, me përjashtim të rastit kur këta persona kanë dhënë më parë miratimin e tyre, kur identifikimi i dëshmitarëve është në interesin e publikut, ose dëshmia ka qenë bërë publike më parë. Në mënyrë të veçantë nuk duhet të zbulohet identiteti i dëshmitarit kur mund të vijë si pasojë vënia në rrezik e jetës ose e sigurisë së tij. Duhet respektuar masat e

parashikuara nga programet e mbrojtjes për dëshmitarët, sidomos ne procedimet penale që kanë lidhje me krimin e organizuar ose me vepra penale me karakter ndërfamiljar”.

Zyra e Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale rikujton se, e drejta e ligjshme për të raportuar fakte me rëndësi publike duhet të shoqërohet gjithmonë nga kujdesi i duhur mbi publikimin e fakteve dhe informacioneve që mund të rëndojnë dhe dëmtojnë subjektet e përfshira në këto ngjarje. Kuptimi i interesit publik dhe rrethanat që përcaktojnë interesin publik sipas përcaktimeve të kreut IX të udhëzimit të sipërcituar duhet të mbahen parasysh në gjetjen e balancës së duhur dhe sasisë dhe kategorisë së informacionit që duhet publikuar. Edhe në prezencën e një fakti në interes publik publikimi i të dhënave personale duhet të respektojë parametrat e thelbit të informacionit.

Sa më sipër,

Në zbatim të neneve 29, 30 dhe 32 të ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”, i ndryshuar.

REKOMANDOJ:

1. Të merren masat e duhura teknike dhe organizative nga kontrolluesi, Televizioni Top-Channel për të bërë të mundur mosidentifikimin e z. në videon e publikuar në faqen e internetit të kontrolluesit në link-un:
<https://www.youtube.com/watch?v=>
2. Të merren masat e duhura dhe të tregohet kujdes në vijë mësi që, në raste të tilla publikimi i lajmit, në kuadër të lirisë së të shprehurit dhe interesit publik, të balancohet dhe të mos anashkaloj respektimin e të drejtës për mbrojtjen e të dhënave personale dhe jetën private të subjekteve të të dhënave personale.
3. Në zbatim të nenit 32/1 të ligjit nr. 9887, datë 10/03/2008, “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”, i ndryshuar, me plotësimin e detyrimit sipas pikës 1, të njoftohet me shkrim pranë Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale.
4. Në rast mospërbushje të këtyre detyrimeve, Komisioneri vepron sipas nenit 30, pika 2 të ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale” i ndryshuar, sipas të cilit... “Komisioneri në rast shkeljesh serioze të përsëritura ose të qëllimshme të ligjit nga një kontrollues ose përpunues, veçanërisht në rastet e përsëritura të rekomandimeve të tij, vepron sipas nenit 39 të këtij ligji dhe e denoncon publikisht ose e raporton çështjen në Kuvend dhe në Këshillin e Ministrave”.

